

DERI NË BALADËN TJETËR

ADEM ZAPLLUZH

DERI NË BALADËN
TJETËR

Redaktor:
Alda Taçe Shpata

Recensent:
Alda Taçe Shpata

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

DERI NË BALADËN TJETËR

ADEM ZAPLLUZHA

DERI NË BALADËN TJETËR

Shtëpia botuese

TRENDI

Prishtinë 2020

*Arkeologjia poetike kalon nëpërmjet
dhimbjes*

ALDA TAÇE SHPATA

Hermeneutika midis poetit dhe pritjes deri në baladën e radhës.

Në dilemat e mia për të marrë në dorë një libër kalibri , libri i 180-të, me përsiatje të forta filozofike në brendi, baca Adem më shkruan :

"Bija ime, shkruaj me shpirt ,sikurse shkruan shpirti im rebel , e nëse janë filozofike ato që unë shkruaj më mirë."

U ndodha në mes të autorit dhe veprës , më duhej të ndiqja një praktikë metodologjike dhe hulumtuese për të interpretuar dhe t'i jepja librit e poetit atë që me të vërtetë u takon .

Produkti shpirtëror i këtyre lirikave të fuqishme kalon mbi njohjet empirike e racionale , ta njohësh në qelizë të gjithë lëndën poetike e mendore të Adem Zaplluzhës do të thotë të njohësh strukturën si tërësi.

Të tri ciklet janë vendosur në lidhje organike me njëra -tjetrën ,organizimi tyre i brendshëm

përbën një semantikë tredimensionale (shënjuesi, i shënjuari, shenja).

Në ciklin e parë "Atdheu im i mjerë, toka ime e djerrë", tabloja e gjerë e imazheve të ndërtuara nga metafora e simbole zbulon tragjikën dhe përceptimin mbi ndjenjat dhe idetë e qenies humanë për ekzistencën e tij dhe të trullit të të parëve. Realiteti historik absurd, ku është në krizë të përhershme njeriu dhe toka, struktura dhe fenomeni, imazhi dhe poezia. Poeti në thellësinë e të ndjerit dhe thjeshtësinë e të shprehurit ndërton pamjen reale të një krize nëpër fusha, qielli i grisur, kambana të shurdhuara, një lloj vaji i trishtuar del nga dheu. Pra kjo tablo poetike të krijon tragjizmin e dheut, e diellit, e ajrit, e bukës, e besimit e këngës. Zaplluzha krijon arketipat, të cilat kanë zënë në kurth atdheun, politikën, moralin, filozofinë, psikologjinë dhe fatin e kosovarit.

Kuptimi i tërësisë së një fenomeni nuk është shuma e thjeshtë e pjesëve përbërëse të tij, por një kuptim i organizuar me domethënie e tërësisë (Totaliteti dhe varësia e ndërsjellë). Pra pjesët janë të ndërthura mes tyre me veçoritë dhe dallimet që ato mbartin.

Në ciklin e dytë "Po ashtu një shi i çmendur", koncepti kohor përzihet me konceptin

hapësinor dhe tragjikisht koha dhe vendi shkrihen në një të tashme të përjetshme.

"Stinët që janë nisur me trenin e fundit nuk vijnë, s'ka Krishtlindje , as baba dimër.

Nëpër ullukët e dhimbjes pikon trishtimi i ditës.

Të grisura si hartat e atdheut ...

A thua vallë do kemi forcë të ecim nëpër golgotën e baladave ...

Desha të blej një gjysmë ëndrre."

Përshkrim absurd, endje e përjetshme, mërzia e përhershme (më e theksuar se te Bodleri), dhimbje që rrjedhë , të gjitha këto elemente ndërtojnë tërësinë e paradokseve reale , dramën e ekzistencës, tragjizmin e psikikës humane .

Nuk arrij të krijoj një imazh të qartë për procesin e të shkruarit ,sesi mund të ndiej kaq thellë dhe si mund të ruaj të pastër arsyen analitike poeti Zaplluzha. "Arkeologjia e diturive" ,strukturalizmi filozofik i Erih From heq paralele me arkeologjinë poetike të poetit , vetëm një gjeni e tillë krijuese mund t'i zbulojë këto struktura poetike, mendore e shpirtërore .

Deri në baladën tjetër është cikli i tretë ,njëherësh dhe titulli i librit .

Intrigues vendi "Te aromat e zambakëve të Prizrenit ", një dëshirë e mbetur pezull ...

Koha si një pushtet i zgjatur dhe i frikshëm dhunshëm masakron dashurinë . Dashuria ndjenjë e fuqishme dhe e pamundur njëherësh , e zhveshur ,lakuriqe , e pafajshme ,e etur për të ndier në qelizë jetën rrëshqet në këto vargje me gjithë vërtetësinë e saj.

“Kur ishte koha të flasim për dashurinë

Ti s'kishe sandale të kuqe

Ashtu si unë që s'kisha këpucë me shollë të trasha

Ishim këmbëzbathur si dashuria jonë .”

Koha dhe fati kanë zënë në kurth dashurinë ,absurdi ka depërtuar në çdo impuls femëror e mashkullor , ia ka veshur dhimbjen ndjenjës , por pa arritur ta tjetërsojë në thelb .

Shqisat lidhen me botën e dëshirave herë të mjegullta , herë të patrajta , megjithatë në çdo rast si forma të qarta imazhesh , ku dashuria megjithëse këmbëzbathur shfaqej në pllanga të dukshme ekzistence .

Ky libër i shtohet koleksionit të madh të veprave të Adem Zaplluzhës me gjithë madhështinë e merituar , sepse paraqitja e tij më fisnike është hermeneutika e tij poetike , e cila do të na lerë të presim "Deri ne baladën tjetër"...

Librin e ardhshëm unë do e doja një baladë tjetër po me këtë arsye analitike,po me këtë strukturë mendore,pikërisht me këtë arkeologji diturie.

Vetëm se nga mendja e mençur e bacës Adem të buronte një vlerësim i ri mbi botën , të shfaqeshin çështje dhe fate të reja mbi kombet dhe mbi njerëzit , të shënohej një 'epokë e re ' e progresit njerëzor ...

Cikli i parë
Atdheu im i mjerë toka ime e djerrë

KTHEHEJ SI NJË BUMERANG I ZJARRTË

Askush më nuk di
Se si përfundoi kjo enigmë e lashtë
Nga mjegullat e plumbta
Dolën si nga ferri
Dymbëdhjetë Kalorës të apokalipsit
Dolën befasisht
Dhe ia prenë kokën diellit

Një hije morbide
Sillej e rrotullohej në qiellin e sterrët
Kërcëllon si e çmendur
Deri te udha e qumështit
Dhe sërish rikthehej
Në pikëtakimin e parë
Rikthehej si një bumerang i zjarrtë

Nëpër rrugë të boshatisura
Pamë njerëz të frikësuar
Njëri mbante nëpër xhepa
Dhëmballët e pjatave të thyera
Të rrufeve
Shirat atë çaste derdheshin
Thua se janë shpuar kazanët e kallajisur

Ishin disa çaste të pa definuar
Buka në sofrën e shtruar
Për dymbëdhjetë kalorës
Mungonte një lugë e thyer
Dhe dy gota të palara
Kush e di se në cilën kohë
Ishin fundosur baladat e kalorësve të zinj

BEREQETI KISHTE VDEKUR NËPËR FUSHA

Në vetminë e trishtuar të lagjes
Dëgjoj zërin e një muzike
Po bien daullet
Po bien për ata që kanë vesh
Po bien e s'ndalen zërat e kambanave

Thonë se qielli është grisur
Kujt t'i besoj
Në këtë kohë të çmendur
Asnjë njeri s'pashë as nuk shoh
Me mendje të shëndoshë

Kanë kaluar disa vite të thata
Pa shi e breshër
Bereqeti kishte vdekur nëpër fusha
Thatësira si një mbret i egër
Sundonte në shpirtin e lënduar të gjelbërimit

SHIKOJ ME VËMENDJE DHE DËGJOJ

Çfarë të bëj në këto çaste delikate
Të bisedoj me erën
Ose t'u flasë drurëve që nuk më dëgjojnë
Janë shurdhuar si kambanat
Asnjë meshë në qytetin tim
Nuk i ngjanë meshave të etërve

Ky fyell prej drurit të mështeknës
Më duket se i ka huazuar
Tingujt e gjetheve
Dhe gjatë tërë kohës
Dëgjoj onomatopenë e stralltë të shkëmbit
Dëgjoj sheshazi
Një lloj vaji të trishtuar që del nga dheu

Shikoj duart e mia të lodhura
Shikoj me vëmendje dhe dëgjoj
Zërin e trishtuar të përroit
Askush nuk paska mbetur
Në këtë lëndinë të djegur
Askush përpos barit të fishkur
Dhe krakëllimave të korbave

PASHË VDEKJEN TIME

Çfarë dini ju për gjethet
Mendoni se jeni të mençur
Sa jeni afër budallenjve
Sa jeni larg vetvetes
Aq jeni afër sa këmisha e juaj
E palarë
Në lëkurën e zhubrosur të lisit

Ku mund të dini ju se çfarë
Kam parë nëpër llagëme
Çfarë s'kanë përjetuar
Sytë e mi të gështenjtë
Nëpër istikamet e trishtimit
Njerëz të djegur
Nga trupit të tyre i vinte era thëngjill

Pashë kuaj të rrjepur dhe njerëz
Që u mungonin
Gati të gjitha gjymtyrët e trupit
Bretkosat që këndonin në kor
Pashë vdekjen time
Në një arkivol të gurtë
E cila edhe në ato çaste s'dinte të qajë

PASTAJ ZGËRDHESHEJ DERISA NUK ÇMENDEJ

Në këtë luftë të pabarabartë e të pistë
Kishte disa lloje vrasjesh
Sokakëve të fëmijërisë
Bridhnin si qentë e tërbuar
Njerëz të huaj
Vraponin si pragjet e kalbur

Dikush ishte vrasës me pagesë
Vrite secilin njeri
Që i pengonte dikujt
Ose i sharronte rrapet shekullorë
Sharronte deri në rrënjë

Unë pashë edhe të tillë
Që e vritnin vetveten në pasqyrë
Sa e sa arkivole
Kalbeshin nëpër korridoret e errëta
Kalbeshin edhe hijet mbi kokat tona

Kështu dukej kjo luftë shfarosëse
Me vrasës me pagesë e pa pagesë
Për pikë të qejfit
Ta gozhdonin plumbin në ballë
Pastaj zgërdhesheshin deri në çmendi

POR ZHURMA E VRAZHDË E LOPATËS

Mbrëmë ishte një natë e shurdhtë
S'dëgjoheshin hingëllimat e mjegullave
Vetëm lehja e tërbuar e yjeve
Tregonte se diçka e jashtëzakonshme
Do të ndodhe te shelgjishtet

Nuk më treguan asnjë fjalë
As zëri i kambanës
S'u dëgjua
Thanë se mesha kishte përfundua para kohe
Atë ditë një arkivol u zhduk te varret

Ne s'ishim në gjendje të besojmë
Ose të mos besojmë
Varret ishin të zhveshura
Asnjë këmishë e bardhë
S'kishte mbetur të degët e akacies

Shikonim të babëzitur rrugëve
S'pamë njeri të gjallë
Por zëri i vrazhdë i lopatës
Ai zë i ndryshkur baritoni
Dëgjohej nga një varr i vithisur

PËR HAJNIT TONA TË VOGLA

Nuk mund të paramendoj askush
Se çfarë do të ndodhte
Me shiun e zi
Që binte në kokrriza
Të mëdha breshëri të kristaltë

Atë ditë ishte e diel
Dita e plakave kur shkonin në kishë
Për larjen e mëkateve
Shkonin edhe të rejtat
Ani që kishin shumë më pak mëkate

Burrat disi nuk e qanin kokën
Nëse nuk mëkatonin
Më shumë se shtatë herë në ditë
Këso lloj mëkatesh
Nuk ishte e mundur të përsëriten

Kurse fëmijët mbase kishin ende kohë
Për larjen e mëkateve
Për hajnit tyre të vogla
Më duket se Hyji nuk kishte kohë
Të merret me dobësitë e kalamajve

KËNAQESHA SI ASKUSH TJETËR

Më duket se që nga vegjësia
Në mua ishte ngulitur një kokëfortësi
E papërmirësueshme
Nuk lejoja askënd
Të hyj në kokën time
Edhe pasqyra e kishte të ndaluar këtë lojë

Gjithmonë pata dëshirë të jem i vetëm
Të ëndërroj fluturimin e lejlekut
Përtej oqeanëve
T'i kaloj malet e larta
Ashti siç do shpirti dhe zemra ime
Me një fjalë doja të jem vetvetja

Dhe isha vetvetja ime
Në kohën time
Dy gurë nuk i lija bashkë
Kënaqesha si askush tjetër
Kur i përcjellja fluturimet e shtërgjeve
I përcjellja në drejtim të atdheut

SA QENKAM ME FAT

Sa jam fatlum që ja grisa astarin
E këtij dimri të acartë
Sa qenkam fatlum
Që mu dha rasti
Të kaloj edhe njëherë ose më shumë herë
Nëpër rrugët e varrezave
Për t'i deshifruar hieroglifët

Sa me pëlqejnë t'i dëgjoj sirenat
E ndihmës së shpejtë
E di dhe jam shumë i sigurt
Që po e çojnë dike tjetër në urgjencë
Kurse unë kam kohë të mendoj
Se kur do të më përlajnë përpara
Rrotat e ndonjë automobili të skaduar

Sa jam me fat kur bie shi
Dhe s'kam ombrellë
Sa jam me fat
Kur dëgjoj cijatjen e një gjallese
Sepse vetëm atëherë
Mund ta ndjej ekzistencën time
Sa jam me fat kur shikoj vetveten në pasqyrë

POR KURRË NUK DO TË PRANOJA

Mund të jem çdo gjë
Por jo aktor
Të shtypi morra mbi dërrasat e teatrit
Disi më ngushtohet frymëmarrja
Të jem dikush tjetër
Në qenien time ta luaj kriminelin

Të jem dashnor i pafat
Ose vrasës si Neroni
Të këlthas nga një ballkon
Që Romës i doli flaka
Derisa zhduket frymëmarrja
E fundit e hirit në sytë e nënave

Mund të jem çdo gjë
Astronaut i dashuruar në yje
Të jem alien
Por kurrë s'do pranoja
Të jem artist teatri
Ose dikush tjetër në shpirtin tim

Prishtinë, 4 mars 2019

ATDHEU IM I MJERË TOKA IME E DJERRË

Atë që deshëm ta quajmë atdhe
Ishte një kafshatë e mykur buke
Na theu dhëmbë e dhëmballë
Na le në mes të rrugës
Mbase ishte kafshata e së nesërmes

Ky atdhe po më duket si flutura
Krah djegur
Sillet rreth qiriut duke kërkuar dritën
Dhe ende nuk kuptoi
Se dikush e fundosi në errësirë

Atdheu im dhe i etërve të mi
Kafshatë me shtatë kore
Kurrë nuk munda të ngopem
Me dashurinë
Mbase as me dhimbjen tënde

U shndërrove në një nocion
Pa shije dhe formë
Atdhe i gjithkujt
Ose më mirë me thënë tokë e askujt
Atdheu im i mjerë toka ime e djerrë

NË HAPËSIRËN E PËRHITUR

Nuk patëm bukë
Për një gllënjë ujë
Me vite e pritëm shiun
Atdheu im
Strall i pafjetur me shekuj

Sa pak të deshëm ne
E sa shumë të deshën të huajt
Moj tokë e lashtë Dardane
Të deshën
Për bukurit dhe pasurit e tua

Ti moj mëmëdhe sa e madhe
Po aq e vogël
Në hapësirën e përhitur
Kurrë nuk arrite deri te udha e qumështit
T'i mëkosh fëmijët që lindën nga guri

JEMI OSE NUK JEMI NJERËZ

Nuk mund të paramendoj askush
Se sa arkivole
Kaluan nëpër duart tona
Kaluan me gjymtyrë të prera
Dhe sy të shkukur nga balli

Kështu dukeshin vdekjet
Të nakatosura
E të trishtuara skajshmërisht
Besa edhe të plaçkitura
Të organeve më delikate

Lufta ishte diçka e tmerrshme
Në secilën kohë
Zhdukeshin të dashurit tanë
Zhdukeshin sepse nuk i përkitnin
Një kombi kanibalësh

Nuk di a thua vallë do të kemi forcë
T'i harrojmë vdekjet e dhunshme
Mbi supet tona
Jemi ose s'jemi njerëz nëse i harrojmë
Eshtrat e groposura
Nëpër varreza kolektive

ISHTE KOHA E VDEKJEVE

Si sot më kujtohen
Uturimat e avionëve
Kur nuk guxonin
Të hingëllinjë as kuajt
Qielli dukej i trishtuar
Prej shrapnelave kur i shponin muret

Diku qante hiri
E diku tjetër dukeshin zjarret
Thua se çdo gjë ndizej dhunshëm
Vetëm lëkura e djersitur e erës
Ngjante me dyllin
Kur shkrihej në shandanin e korridorit

Dukej edhe një lloj errësire
Po të mos ishin xixëllonjat
Në paradhomën e ëndrrave
Sterra do na i verbonte sytë
Ishte koha e vdekjeve kur lëkura e njeriut
Nuk vlente një lekë të mykur

POR GJITHSESI ISHTE NJË KOHË ASNJANËSE

Ngado që sillem
E vërtitem
Më godasin erërat e liga
Një shi i rreptë
I këputi zambakët që në rrënjë

Nëpër trotuare kalojnë lypsarët
Kalojnë përballë meje
Me nga një trastë të grisur
Që u ngjajnë flamujve të luftës
Dhe atyre të trishtimeve

Një degë e këputur ulliri
Hyri në poezinë time
Hyri si një kardinal
Dhe i mbylli të gjitha portat
S' gjeta dot asnjë dalje deri te ti

Nuk më kujtohet ishte ditë
Ose një natë e pikëlluar
Por gjithsesi
Ishte një kohë asnjanëse
E cila vërtitej si një balon i fryrë

NJË STUHI E URITUR PËSHILLEJ

Duart e saja të zverdhura
Dhe lakuriqe
Si vetë lakuriqësia
Përqafonin bisqet e shelgjeve të njoma
Ku qëndronin ulur ose kacule
Mbi stolin e vjetër
Dhe ëndërronin të kaluarën e largët

Asgjë nuk ngjau rastësisht
Atë ditë
As që do të ngjajë ndonjëherë
Ajo i shikonte rrënjët
I shikonte përtej tokës
Duart e fishkura të vjeshtës
Që depërtonin nga pasqyrat konvekse

Një stuhi si ujku i uritur
Na pështillej
Tmerrësisht pështillej
Përreth këmbëve të rrapit
Kurse mali kollitej
Kollitej duke gërhitur
Si i moshuari prej niktine

PASHË SE SI IU NXINË KOKRRAT E SYVE

Edhe po desha
Nuk mund t'i harroj vitet pesëdhjeta
Isha në klasë të parë
Mbase isha edhe në të dytën
Por gjithsesi atë ditë isha i uritur

Me shumë mund dhe sakrificë
Qëndroja në këmbët e dobëta
Shoku që rinte ulur me mua
Lavdërohej se kishte ngrënë
Në grusht thelpinj arrash të thyera

Befasisht pas pak kohe
Iu turbullua koka
Ose rropullitë gurgullonin si përroi
Filloi një gogësimë e thellë
Më pastaj i vjelli të gjitha arrat

Barku i tij ushtonte si një madem
Ku thyheshin gurtë e murrmë
Pashë se si iu nxinë
Kokrrat e syve
Kurse ne shokët e klasës
I ndihmonim duke i shikuar të vjellat

PASTAJ TË MARR UDHËN E KALASË

Sot befasisht me një afsh të pa përrshkruar
Më lindi një ide dhe dëshirë
Me një zambak të bardh në dorë
Të kaloj nëpër urën e gurit
Dhe të ulem si dikur
Në kafenenë time të pi një kafe farmak

Pastaj të marr udhën e kalasë
T'i ngopi mushkрит me oksigjen
Derisa ta vras nikotinën
Me ajrin e pastër të Sharrit
Të ulem mbi bedenat e lashtë
E të sodisë çatitë e vjetra të Prizrenit

Nëse më zë lodhja e tepërt
Pushoj te Qeshma e Pashës
Pi vetëm një gllënjë ujë të akullt
I mbushi mushkрит
Me aromën e lules së shtogut
Dhe dashurinë e rrapeve

E T'I NUMËROJ METEORËT

Sonte dua të jem vetëm
Në hapësirën e virgjër të qiellit tim
T'i shikoj yjet
Kah ngarendin nëpër mjegulla
Ngarendin si kuajt e egër të fëmijërisë
E të kënaqem me harmoninë e qiellit

Të shtrihem në gjumin delikat
Mbi barin e njomë të vendlindjes
E t'i numëroj meteorët
Që bien nëpër fushat e mëllenjave
Sepse këndeje thonë
Asgjë më mirë s'ka se sa t'i numërosh yjet

Pastaj të ulem si dikur
Nën hijen madhështore të rrapit
Fëmijëve të fshatit
Tu tregoj përralla të moçme shqiptare
Që u lindën pas përfundimit
Të luftës së çmendur në atdheun tim

**THUAJSE NJË DORË UA VURI
ZJARRIN**

Këtu në këtë lëndinë
Më kanë mbetur ëndrrat
Kanë mbetur si fosilet e një qyteti
Të vdekur dikur moti
Më kanë mbetur edhe kujtimet

Asnjë kronist s'mbajti shënime
Andaj edhe i thonë
Se ky qyteti vdiq para se u lind
Vdiqën edhe rrugicat me kalldrëmet ilire
Thuajse një dorë ua vuri zjarrin

Këtu dikur kur jetonin njerëzit
Kishte tregime fantazmagorike
Por fshehtësitë e këtij qyteti
Ishin gjykuar
Të mos paraqiten as nëpër përralla

ISHTE KOHA KUR PIQESHIN FTONJTË

Të kam thënë me qindra herë
Se unë të pres
Të pres si toka e etur shiun e pranverës
Të pres kur bie borë e breshër
Gjithmonë kam me të pritur në alenë
E brishtë të kujtimeve

Ti mos u ngutë gjithmonë
Do më gjesh te sheshi
Ku i humbëm të gjitha sumbullat
Të kujtohet
Ishte koha kur piqeshin ftonjtë
Dhe iknin shtërgjet nga brigjet e qiellit

Ja pra askush nuk di se sa herë lindi
Dhe perëndoi dielli
Në Fushën e Pajtimit ku binin në tokë
Ftonjtë e pjekur
Kurse mua më gjenin duke pritur
E unë nuk di se çfarë prisja atë ditë

KY DIMËR E KJO DËBORË

Më duket se vetëm kjo pemë
Paska mbetur si statuja
Në bulevardin e kujtesës
Paskan ikur edhe zogjtë shtegtarë
Janë larguar nga sheshi
Gazetashitësit monoton

Ky dimër e kjo dëborë
E njollosur në të zezë
Nuk e kanë vendin në lagjen tonë
Pemët e ngrira
Mbase nuk do mbërrin
Të ja shohin syrin pranverës

Në pikë të ditës
Kjo messtinë e ka humbur udhën
Asnjë xixëllonjë sonte nuk bënë dritë
Në lagjen e evgjitëve
Përfundimisht
Qenkan shurdhuar daullet

ATA S'KISHIN ASGJË PËRPOS SHPIRTIT

Ata s'kishin asgjë
Përpos shpirtit lakuriq
S'guxonin as të vdisnin
Në befas
S'kishin asnjë lekë për blerjen e kryqit
As mundësi
Për një arkivol të dinjitetshëm

Kurse për meshën
Asnjëherë s'kishin çarë kokën
Mund të udhëtonin si gjithmonë
Në ndonjë karrocë
Me kuaj të plakur e të zgërlaqur
Nuk e lodhnin kokën
Se me çfarë do të mbërrin te varret

Ata s'kishin asgjë pas shpirtit
Ishin një ushtri e madhe
Që s'mendonin askurrë
Se ku do blejnë një varr
Dhe në cilin vend do varrosen
Te varret e qytetit
Apo diku ku s'kalon asnjë kalimtar

Prishtinë, 5 mars 2019

Cikli i dytë
Po ashtu një shi i çmendur

I KISHTE DEHUR KAPRONJTË E THINJUR

Sivjet s' do të vijnë Krishtlindjet
Po ashtu edhe baba dimri
Për Vitin e Ri
Një ortek i madh dëbore
Ua ka zënë rrugën
Stinëve që janë nisur me trenin e fundit

Ju thashë se sivjet
Domosdo do të kemi
Shumë probleme meteorologjike
Stinën janë kthyer
Për së mbrapshti të rrjedhin
Pranvera ia ka zënë rrugën dimrit

Kurse vjeshtës i kanë mbetur këmbët
Peng dhe e paska humbur rrugën
Në pikë të ditës
Dikush udhëve dhiare
I kishte dehur kaprojtë e thinjur
Andaj edhe stinët do vonohen sivjet

DIGJESHIN GURTË E NGULUR NË DHE

Rrugëve pashë
Shumë pemë të karbonizuara
Fëmijë të nakatosur
Me sy prej thëngjilli
Bretkosa duke kënduar
Në një kor madhështor prej hiri

Nëpër lëndina hasa në kërcu
Të shkruaruar
Diku sinorëve të shkukur
Digjeshin gurët e ngulur në dhe
Aq të forta ishin zjarret
Sa që piqeshin breshkat në rërë

Gjithkund zjarre të ndezura
Njerëz me maska
Dhe nëna të thinjura
Me gjinj prej plastike
Nëpër asfaltin e zhuritur
Vallëzonin tangon e paparë të zvarranikëve

PEMËT LAKURIQE NË DY GJUNJË

Hasa në sy të mavijosur të pemëve
I tërë kopshti
Ishte shndërruar në një arenë lufte
Dizgjinët e këputur
Aty këtu mëgojëza të thyera
Dhe thundra të shkultura kuajsh

Një metamorfozë e padëgjuar
Shtrihej nëpër luadhet
E kositura dhe të djegura
Prej zjarreve të shrapnelave
Zogj pa krih me një trëndafil në sqep
Fluturonin nëpër ajrin e gjymtuar

Era përplot lagështi
Kundërmonte një lloj vdekjeje
Të padëgjuar deri më sot
Pemët lakuriqe në dy gjunjë
S'kishin shamia për t'i fshirë lotët
I përdornin fashat e gjakosura prej plagëve

NË MES TË UDHËS SË THYER

Nëpër ullukët e dhembjes
Pikon trishtimi i ditës
Sorrat në fluturim e sipër
Po i harrojnë krakëllimat
Një gjysmë diell i shëmtuar as nuk ngroh
E as nuk na i ngrinë eshtrat

Mbase paskemi mbetur
Diku askund
Në mes të udhës së thyer
Ndarë në disa drejtime
Kah do të fluturojnë shtërgjet
Ende s'paskan vendosur

Kjo heshtje mortore
Po i verbon drurët e shurdhtë
Nga lastarët e këputur pikon dita
Një lindje e trishtueshme
Mbase dallohet
Si në veri po ashtu edhe në jug

TË GRISURA SI HARTAT E ATDHEUT

Kjo vdekje e gurëve
Dhe e drurëve nuk paska të ndalur
Askush më nuk di
Se ku gjenden
Varret e posa të hapura
Si do të varrosen kufomat e karbonizuara

Këtij dielli të gjymtuar
Nuk i paska mbetur asnjë pjesë
Pa u nakatosur
Nga koka deri të këmbët
Qenka mbështjellë me fashat
E palara të betejës

Kudo gjymtyrë të thyera
Nëpër rrugë
Thonj të shkukur me darë të urrejtjes
Kërma derrash dhe lëkura të grisura
Nëpër skuta
Të grisura si hartat e atdheut

DY FLUTURA MBI TAVOLINË

Ky ajër i ndotur
Po i shëmbëllen ngjyrës
Së përhitur të thëngjillit
Çdo gjë këtu
Paska marr formën e vdekjes

Dy flutura të zeza mbi tavolinë
Po i numërojnë çastet e fundit
Të një nocioni
I cili po zhduket në fjalorin tonë
Të pakuptimtë

Dje i dërgova dy kartolina
Një të verdhë
Kurse tjetra e përhitur
Gjërat po marrin formën e hirit
E tërë hapësira digjet si dielli

Sërish dy pëllumba fluturuan
Në drejtim të qiellit
Fluturuan tërë hidhërim
Pa i rrahur dy herë krahëve
U plandosën si të vdekur në tokë

POSA IA NISIN FLUTURIMIT

Një kundërmim i rëndë
Në ajër
Posa ia nisnin fluturimit
Ngordhin mushkonjat

Nën pemët e zhveshura
Nuk ka se ku të ulen zogjtë
Fashat e vdekjes
Po ngufasin frymëmarrjen e ditës

Dy lejlekë ikën nga çatia
Këndesi i metaltë
Nga një acar i padëgjuar
Qëndronte i ngrirë mbi oxhakun e shtëpisë

SI ZOGJTË E EGËR PA PENDLA

Nuk di s'jam në gjendje të orientohe
Se kah po na çojnë
Këto udhë të zeza
Një betejë e madhe
Duket në hapësirën e përhitur

Qielli pa asnjë shpend
Kurse retë e dendur
Nuk i ndalin krakëllimat e trishtuara
Disa hije vdekjeprurëse
Po sillen mbi kokat tona

Jemi qenie të humbura pa maska
Mes kësaj humbëtire
Kemi mbetur të vetmuar
Si stuhia pa orientim
Vendnumërojmë në trishtimin tonë

Njerëzit pa vetëdije
Si zogjtë e egër
Shikojnë një tjetër diell
Shikojnë dhe s'besojnë
Se çfarë janë duke parë

KËMISHËT E GRISURA DHE NJERIU LAKURIQ

Ca stërkala gjaku të mpiksur
Në këmishën tënde të bardhë
Dukeshin si plagët e një lufte
E cila kurrë s'kishte kaluar
Nëpër lagjet e të trishtuarve

Këmishët e grisura dhe njeriu lakuriq
Me një copë dhembjeje në dorë
Ecte rrugëve të kalldrërta
Ecte si një qenie mitologjike pa kokë
Mbase ishte drejtuar kah theqafja

Mbi kokë i rinin disa lloje hijesh
Të murrme dhe të verdha
Rinin si një oreol i braktisur
Ndoshta të ndonjë shenjtori
I cili kishte mohuar vetveten

Çfarë nuk sheh njeriu
Nëpër brigjet e vetmuara të Lumëbardhit
Zambakë të fishkur po ashtu
Edhe trëndafila pa shpresë
Me një aromë të vdekur para shumë shekujve

JO SE JO

Të kaloj njëherë urën e premtuar
Pastaj le të ndodh
Edhe ajo më e keqja me mua
E di
Çfarë kam mbjellë domosdo
Një ditë duhet të korri

Kurrë nuk kam qenë engjëll
Ama as djall
Jo se jo
Isha një poet kryengritës
I cili gënjeshtër
Kurrë në jetë nuk i tha po

DIELLI KËTU LIND NË PERËNDIM

Këto mjegulla të ngopura
Me shijen e hirit
Dhe të vdekjes
Duken edhe më të hirta
Kur fillon përpëlitja e vesës mëngjesore

Nëpër rrugë shoh arkivole
Të kalbur
Njerëz me dhe pa gjymtyrë
Një flakë e verdhë
Ngufat virgjërinë e natyrës

Dy dimra dhe një pranverë
Kaluan nën acarin e frikës
S'patën forcë
Të më ngrohin as plumbat vrapar
Dielli këtu lindte në perëndim

ASNJË QEN ENDACAK

Një erë e rëndë fosfori
Përzier me atë të naftalinës
Po ja zë frymëmarrjen
E diellit të shëmtuar

Shumë plagë vdekjeprurëse
Shoh në horizont

Kalamendem si i dehuri
Nëpër alet e trishtuara
Të kolonadave

Asnjë qen endacak
Nuk bredh
Nëpër dhembjen e trotuareve

Njerëzit kanë ikur diku
Mbase as vetë nuk dinë
Se ku shkuan

Shiu i plumbtë dhe i metaltë
Troket nëpër asfaltin
E djegur
Ku mbetën peng përgjithmonë
Shollat e fundit
Të këpucëve të blerë në tregun e plaçkave

A thua vallë
Do kemi forcë të ecim
Nëpër golgotën e baladave

NËN INGRANAZHET E VDEKJES

Nën ingranazhet e vdekjes
Një grusht kockash
Përpëliten si njeriu i gjallë
Përpëliten kur u bie mbi kokë
Zifti i valuar nga kazanët

Më shumë se njëqind vjet
Nuk bëra një sy gjumë
Në qiell dhe nën tokë
S'pushonin vigmat e krakëllimave
S'pushonin as uturimat e duraluminit

Nuk desha por nuk pata rrugëdalje
I lashë peng gjymtyrët
Asgjë tjetër më shumë
Nuk isha në gjendje
Të bëjë për atdheun tim të sfilitur

Atë ditë i vajtova me kujë të gjitha baladat
Qava edhe të nesërmen
Më ikën zogjtë e mendjes
Asnjë shpresë nuk mbeti për më vonë
Ani që shpresa vdes e fundit

SI T'I SHËROJ PLAGËT E LUFTËS

Paskan filluar të më dridhen duart
Si t'i shëroj plagët e luftës
Këta zjarre
Që s'dinë të shuhen
Më shumë se njëqind ose dyqind vjet
Po ndizen në heshtje

Nuk doli asnjë njeri i vërtet
I cili mund t'i ndalte flakët
Që po ia lëpinë
Lëkurën e djegur të qiellit
Dy pëllumba të egër në një lis
Me xhelozë po fshehin një plis

Për çdo ditë shikoj duart
Shikoj që dridhen si teli i kitarës
Si t'i shëroj plagët o atdhe
Si mund të të ndihmoj në këto çaste sublime
Atdheu im i lashtë
Zëri gjaku dhe shpirti i etërve të mi

NUK DI A THUA VALLË MË DUHET

Nuk di se sa kohë kaluan
Por unë ende kam mbetur
Diku te fundi
Duke i rregulluar çastet
E shprishura
Të shprishura si flokët e thinjura të erës

Dëshirat ishin të mëdha
Dy ose shtatë herë
Më të mëdha se mundësitë
Sa herë që desha
Të ja rregulloj vetullat
Pa dashje ua nxora sytë

Nuk di a thua vallë më duhet
Të kërkoj ndjesë
Për mëkatet që bëra ndaj pemëve
Ose pa dashje
I shkula rrënjët e tregimeve
Nga enigmat e etërve të mi të stralltë

FSHIHESHIN MERIMANGAT E ZEZA

Nëpër skutat periferike të qytetit
Atje nëpër ato plagë
Ku s'fluturonin as lakuriqtë e natës
Vdekja rinte kacule
Rinte për një kafshatë të mykur buke

Nuk hyre në brendinë e pasqyrës
Në atë thellësi
Të turbullt
Fshiheshin akrepat e zi
Fshiheshin si hajdutët e shtëpive

Ishte një ditë me riga të imta
I lagte flokët e shprishura të çative
Mbase nuk kishte tjetër ku të binte
Kishte mëri nga kufomat mbi tokë
Që kundërmonin vdekje

Sërish shiu i zi
Trokite nëpër portat e drurëve
Trokite si i çmendur nëpër plagë
Asnjë zë njeriu nuk dëgjuam
Përpos uturimave të metalta mbi mjegulla
Prishtinë, 6 mars 2019

DUHEJ TË BARTEJ DHEMBJA

Ishte koha kur duhej të bartej
Pesha e rënd e fjalës
Ose e pikëllimit
Duhej të bartej dhembja
Nga e cila pëlçasin mermerët e Kosovës

Dhe i bartëm në harmoni
Me të kaluarën e afërt
Bartëm të sotmen e plagosur
E cila cijate si një qenie
Jashtëtokësore
Cijate për ta zgjuar të atdheun

E kaluara nuk kishte asnjë kuptim
Në fjalorin e erës
Një gërhitje e rënd
Sikur të gërryhej teneqja
Prodhonin mushkëritë e infektuar
Mbase ishte dhembja në metastazë

Nëpër korridorin e lagshtë
Filluan të galopojnë kuajt e egër
Të galopojnë edhe mjegullat skutave
Dhe galopuan mu në atë çast
Kur e mësuan
Përmendësh pantomimën e dhembjes

PO ASHTU NJË SHI I ÇMENDUR

Ishte një kohë asnjëse
As e gjinisë mashkullore
E as të asaj femërore
Një gjini
Mes dy ose më shumë gjinive
E cila krijonte
Një frikë të paparë në mua

Thonë se lufta është e çmendur
Por ajo ha njerëz
Kurse i çmenduri
Si gjithmonë
Jeton me hallet e veta
Jeton pa e ngacmuar askënd
Përpos vetveten e lënduar

Vonë kuptova
Se mbrëmë kishte zbritur
Po ashtu një shi i çmendur
Sa që kishte qenë
Në një gjendje tepër të rëndë
Dhe u alivanos duke i shkukur
Rrënjët adventive të tokës

DERDHEJ NGA KAZANËT E SHQYER

Ku të fshihem nga kjo luftë
Në cilën shpellë
Parahistorike
Ta hapi një hendek për varin tim
Kjo vdekje e ngadalshme
S'paska të ndalur sonte

Nga të gjitha anët
Frynte një erë e lig
Nëpër kopshte shkundeshin frytet
E sëmura të pemëve
Vetëm ato të egra
I rezistonin kohës dhe kësaj katastrofe

Shiu i mbrëmshëm
Nuk dukej se ishte
Një shi normal
Derdhej nga kazanët e shqyer
Prej cerberëve të ferrit
Derdhej nga ullukët e çative të rrënuara

I PAMË KUFOMAT

Nuk duhet të befasohemi
Për asgjë
Ne i pamë vdekjet nëpër rrugë
I prekëm kufomat
Nga vrasësit me pagesë
Dhe pa pagesë

Kriminelë të çdo profesioni
Mjekë që abortonin
Në çdo kohë adoleshentet
Profesorë që në secilin xhep
Kishin nga një diplomë
Moralin që shitej nëpër pjatat e palara

Pamë edhe xhambaz gomarësh
E kuajsh të tredhur
Njerëz me shtatëqind fytyra
Kasap të pandershëm
Duke shitur qenin e rrjepur
Dhe klerikë pedofilë
Me nga një kryq prej ari

NJË PLUMB DREDHARAK

Nëse duhet mbaje fortë
Ison e krismave
Mes dy luleve mos e këput atë
E cila në vete
Përmban aromën e pranverës

Ti nuk ke nevojë për heshtje
Poetët megjithatë
Janë njerëz që i përbuzin frikacakët
Loja e thikave
Gjithmonë ka qenë tragjike

Më kujtohet ti s'ishe në gjendje
Ta kontrollosh frymëmarrjen
Secilën herë
Kur bie ndonjë shi monoton
Ty të tkurren pantallonat

Nuk më kujtohet mirë
Nga cila anë shikoje tmerrin
Kur dëgjoheshin krismat në lagje
Një plumb dredharak
Gati se t'i përzhiti këpucët e reja

I NJOHU QESHJET IRONIKE

Asnjëherë nuk kuptuam
Se kush ishin ata që trokitën
Dhe pa u çelur portat
Ikën me sterrën
Ikën dhe kurrë më
Nuk u dukën në fshatin tonë

Dikush thotë se ishin njerëz
Me maska të zeza
Kurse të tjerët kokëfortësish pohojnë
Ishin fqinjët tanë
Me fytyra të ngjyrosura
Me bojë prej dheu

Ani që ishin të mbyllura portat
Druri i bungut plak
I njohu për mrekulli
Fytyrat e zeza
I njohu qeshjet ironike
Të skileve nga stepat e egra

I CILI ENDE NUK ËSHTË NISUR

Paramendo një stinë të re
Pa gjethe
Me trëndafil të venitur
Në dy vazo të metalta
Të rritej një lule e egër stepe

Shikoje në pasqyrë vetveten të etur
E të uritur
Se si në dy gjunjë shikon diellin
Kah t'i përvëlton trutë
E ti askund nuk gjen një hije shpëtimi

Nuk di si mund të duken çastet
E pritjes së shiut
I cili ende nuk është nisur
Nga vorbullat e dendura të mjegullave
Çfarë durimi mund të lind në vazo

Kurse trëndafilin për mrekulli
Është në gjendje për ta kontrolluar
Frymëmarrjen tënde të shpeshtuar
Stërkalat e shiut sonte
Me qëllim vonohen për njëqind vjet

QENKAN ÇUAR PESHË RETË

Ishin boshatisur të gjitha rrugët
S'dëgjohej asnjë lehje
Mbase edhe qentë endacakë
I kanë mësuar
Për mrekulli
Vendet e fshehta të strehimoreve

Alarmet e qytetit u ngjanin
Shurdhmemecëve
Alarmonin me tërë forcën e zërit
Por askush nuk reagonte
Mbase ishin shurdhuar
Edhe shtyllat elektrike

Kjo zbrazëti rrugësh
Nuk ka një ogur të mbarë
Nga veriu
Janë nisur disa re të zeza
Dhe si të çmenduara
Ia kanë mësy portave të qytetit

MUND TË THEM EDHE SHATË

Kurrë nuk arrita të mësoj
Se sa vjet i kam mbushur këto ditë
Më duket se kam harruar
Çastin kur trokita për herë të parë
Në portet e hapura të Ferrit

Unë u drejtova te ato të tjera
Por nuk di se si
Një dorë e vrazhdë e jetës
Gjithnjë më shtynte me rrëmbim
Kah këto porta të zeza

Më duket se atë ditë kisha një maskë
Dhe kur hyra brenda
Nuk më pranuan
Thanë se duhet hequr maskën
Por diçka më shtynte të veproj të kundërtën

Ku ta di tani se sa vjet i kam
Mund të them edhe shtatë
Ose shtatë dhjetë e shtatë
Por çfarëdo që pohoj në këto çaste
Ju gjithsesi s'do të më besoni

DESHA TË BLEJ NJË GJYSMË ËNDRRE

Në këtë qytet fantazmash
Ëndrrat nuk kushtojnë shtrenjtë
Janë të lira shumë më të lira
Se maskat e zeza
Ose blej çfarëdo ngjyre qoftë
Paguan një ta japin falas tjetrën

Kurse për ëndrrat
Ani që nuk kushtojnë
Aq shtrenjtë
Janë të ndaluara shitblerjet
Kush e di se nga cila kohë
Vlen ky dekret nga të çmendurit

Njëherë moti
Në një kohë asnjëse
Desha të blej një gjysmë ëndrre
Por sërish ishte e ndaluar
Atë ditë pata fat të blejë
Vetëm një zhgjëndërr të trishtuar

NA I SHËNOJNË TË GJITHA ËNDRRAT

Vonë kuptuam se nuk kemi
Ëndrra të harruara
Në këtë qytet të mistereve
Kemi kronist të përsosur
Që me një përpikëri të madhe
Na i shënojnë të gjitha ëndrrat

Njëri një ditë më ndali
Dhe më befasoi për mrekulli
Kur më pyeti se sa paguaj
Për një ëndërr nga adoleshenca
I kontrollova xhepat nga rrudhja e krahëve
Fare mirë kuptoi se s'kisha asnjë lekë

Ishin të kota më vonë bredhjet e mia
Pas asaj ëndrre
Kronistin thua se e përpiu toka
Kurrë më nuk e pashë në qytet
Dhe që nga ajo kohë fatkeq
Mbeta duke kërkuar ëndrrën time

SONTE KJO NATË E ASKUJT

Sonte kjo natë e stërgjatë
Nuk qenka e askujt
Të gjithë ngarendin
Në disa drejtime të dyshimta
Asnjëri nuk di
Se si të orientohet në këtë zagushi

Nëpër rrugicat e kalldrëmta
Dhe të ngushta të kasabasë
Dëgjohet zëri i vonshëm i simitçiut
Thua se në këtë qytet
Vetëm me këtë lloj gatese
Njerëzit e mbajnë frymën gjallë

Sonte kjo natë e askujt
I ka lëshuar frerët
E mëgojëzave të ndryshkura
Dhe galopon e shkujdesur
Galopon derri në çmendi
Duke trokitur nëpër portat e mbyllura
Prishtinë, 7 mars 2019

Cikli i tretë
Deri në baladën tjetër

TI MOS HARRO KOHA ËSHTË

Kur vijnë çastet delikate
Ato më pikante të dashurisë
Të kam thënë njëherë
Se domosdo do shihemi
Te aromat e zambakëve të Prizrenit

Ti mos harro koha është
Të japim
Dhe marrim çdo gjë nga njëri – tjetri

Sipas të gjitha ligjeve e gravitetit
Dhënia dhe marrja
Nuk kanë asnjë ndryshim rrënjësor

Janë aq të ngjashme
Sa që asnjëherë në jetë
Nuk ishim në gjendje
T'i dallojmë ndryshimet

Një ditë vjeshte ose pranvere
Stinët nuk luajnë
Asnjë rol esencial
Në jetën e trëndafilave

Ne dhamë aq shumë
Po aq sa edhe morëm
Nga njëri - tjetri
Sa që mbetëm si statuja të ngrira
Duke kontrolluar frymëmarrjen e erës
Në stacionin e vjetër të trenit

NUK DI CILI DJALL HYRI

Nga po vjen ose ku po shkon
Sonte je në përcjelljen e yjeve
Meteorët endacakë
Si shirat po derdhen
Mbi flokët e tua të mëndafshta

Ky buzëkuq i mbrëmjes
Paska një aromë krejtësisht tjetër
Nuk është si ai i nëntorit të kuq
Shijen dhe aromën
E paska huazuar nga buzët e tua

Ndoshta të kujtohen çastet
E djersitjes së mureve
Era i shqelmonte dyert e mbyllura
I shqelmonte
Si një hamshor i patredhur kujtimet

Sonte më nuk jam vetvetja ime
Nuk di cili djall hyri
Nga dera e pasme e kujtesës
Hyri dhe i theu të gjitha pjatat
Që mbetën të palara mbi tavolinë

DRIDHESHE SI THUPRA E ÇELIKTË

Këto ndjenja të grumbulluara
Në një thes plastike
Nuk duken të lumtura
Secila me nga një maskë të zezë
Parakalon shëtitoreve të kujtesës

Kur ishte koha të flasim për dashurinë
Ti s'kishe sandale të kuqe
Ashtu si unë që s'kisha
Këpucë me sholla të trasha
Ishim këmbëzbathur si dashuria e jonë

Kur ta kapa dorën më duket se
E mbaja në duart e mia
Shelgun e pikëlluar
Dridheshe si teli i çeliktë
Në telin e paakorduar i kitarës

Ja se si dukej dashuria
Në kohën tonë
As nuk ishte e veshur e as lakuriqe
I shëmbëllente mollës së kuqe
Ec e puthe në atë lartësi të degëve

FLUTURAT E BARDHA DHE TË KALTRA

O flutura të plagosura
Sa pak paska vend për ju
Në luadhet e kositur
Të dhembjes
Nga cila anë frynte murrani
Që mbetët me flokë të shkulura

Flutura të bardha dhe të kaltra
Fluturojnë nëpër imazhet e fëmijërisë
Fluturojnë
Në drejtim të panjohur
Në asnjë mol të braktisur të tavernave
Nuk e lëshojnë spirancën e dhembjes

Fluturat e mia të kaltra
Dhe të bardha
Ikët diku larg
Larg në një qytet pa adresë
Në asnjë pergamenë të shpirtit
Nuk e shënuat biografinë e largimit

SI DRURËT STEPESHIN NJERËZIT

Sonte si herëve të tjera
Në kujtesën e bulevardit
Një pëllumb i sëmurë
Me plagët e dhembjes
Shëronte fashat e gjakosura
Të një stine të vdekur

Njerëzit pohuan se këtu
Kurrë nuk ka qenë pranvera
Gjithmonë dimri me acar ndër dej
Kalonte këmbëzbathur
Kapërcente
Nën urën e ngrirë të Lumëbardhit

Si drurët stepeshin njerëzit
Kjo vdekje e trishtuar
Nuk gjente askund vend
Për arkivolin e saj të gdhendur
Në kujtimet e huazuar
Prej kalimtarëve të rastit

ASAJ I MUNGONIN LEKËT PËR ARKIVOL

Ajo jetonte me një ndihmë sociale
Nuk kishte mundësi materiale
Ta paguaj as rrymën
Për çdo mbrëmje dikur vonë
Ndizte nga një qiri
Për t'i ngrohur gishtat e holla të kufomës

Nga flokët e zbardhura si dëbora
Këputeshin thinjat e flokëve
Të cilit me xheloz
I ruante në një zarf të kaltër
Dhe thoshte se nuk guxon të vdes
Sepse i mungonin lekët për arkivol

Prej të tjerëve kuptova
Se ishte nëna e një luftëtari
I cili si një hero sypatrembur
Kishte rënë dëshmor
Në kufirin Shqiptaro - Shqiptar
Duke bartur armë djemurisë së Dukagjinit

NGA MRENDIA E SAJ

Mos u friko si në fëmijëri
Nëse në brendinë tënde
Dëgjon zërin e gjinkallës

Pranvera gjithmonë këndon
Kur ti mendon se ajo ka vdekur
Më kujtohen stinët e egra
Kur nuk guxonim as të dashuronim

Për ne dashuria e atëhershme
Ishte diçka e largët
E paarritshme dhe e sofistikuuar

Flutura me shtatë lloj krahësh
Hëna që fshihej pas diellit
Vetëm kur iknin mjegullat e zeza
Paraqitej në sagën e kujtimeve

Sa herë guxua që në
Korridorin e djersitur ta prekim pasqyrën
Nga brendia e saj buronte dhembja

Më pastaj
Mbinte një lule me të gjitha ferrat e botës
Dhe nga sytë e kornizës
Pikonte një lloj dylli i verdhë
Për të mbyllur veshët nga sirenat e Odisesë

NUK U PËRKULËM ASNJËHERË
(Varianti i dytë)

Unë kurrë nuk isha Romeo
Ama as ti s'ishe Zhulieta
Por prapë se prapë
Nuk lejuam
Që në mënyrë të pamëshirshëm
Të na shqelmoj jeta

U ballafaquam edhe me
Djallin e zi
Nuk u përkulëm asnjëherë
Ecëm kryelartë shëtitoreve
Kur binte breshër
Edhe kur binte shi

Na e zunë udhën
Të shtatë kalorësit apokaliptik
Sërish depërtuam
Nëpër atë shtjellë si uragan
Ia dolëm në dritë
Duke përbuzur çdo stramastik

DERI NË BALADËN TJETËR

Ah të mira edhe të trishta
Ishin baladat shqiptare
Një nënë
Si një qyqe vajtonte
Mbi një varr

Dhëndrin e vrau pashai
Kurse nusja
Përpëlitej pa kokë mbi bar
Posa kishte filluar nga pema
Të shkundej lulja e parë

E mirë dhe e trishtë
Qe jeta jonë e uruar
Kurrë nuk iu dorëzuam
Armikut të pabesë
Gjithmonë vdiqëm duke kënduar

Prej një balade
Deri në baladën tjetër
Udhëtonin krushqit mbi re
Por se lëmë pas dore kodin e vjetër
I cili gjithmonë bashkëjetoj me ne

U HARRUAN TË GJITHA MALLKIMET

Sa të mençur dhe sa të trishtuar
Dolëm nga baladat
Një kanjushë e zezë
Fluturon mbi çatitë e qytetit
Mjegullat e dendura ikin tej maleve

Kaluan ndoshta qindra vite
Edhe po aq decenie
Guri i fjetur kurrë më
Nuk i mbylli portat e mbyllura
Të mermerëve të Kosovës

Një plumb kobzi fluturoi
Si çafka e mallkuar
Fluturoi
Mbi qeleshën time të bardhë
Dhe ja skuqi parzmën rrapit shekullor

Drutë në dy gjunjë
I harruan të gjitha mallkimet
U stepën si një gur i murrmë
Kryqi heshti njëherë e përgjithmonë
Heshti mbi varrin e vithisur

KALI IM I PAFAT

Kali im i bardhë për cilën luftë
T'i mbathën potkonjtë
Për kë do vraposh
Në bejlegun e vdekjes
Kali im i pafat
Kali im i bardhë e zi

Mbrëmë ta vumë kapistrën e re
Dizgjinët prej mjegulle
T'i vendosëm në gojë
Sa me hijeshi vrapoje
Deri te vdekja e jote
Kali im i bardh kali im i zi

Nuk di sa njerëz i barte mbi shpatullat
E baladave të lashta
Ti kali im i pafat
Me mëgojëza prej ari
Sa që mbete pa asnjë dhëmb
T'i shkulën edhe thundrat
Kali im i zi kali im i bardhë

DIELLI SI NJË PATATE E DJEGUR

Në çdo kohë të ditës
Pemët i ndërrojnë ngjyrat
Si nga baladat bien gjethet
Dhe ngritën degët sërish lart

Diku larg në shpirtin e shkretëtirës
Një gur ëndrre
Në sqepin e një shtërgu
Ndërtoi një çati

Nga majat e kaktusit
Pikonte etja e paparë e diellit
Rërën e përskuqur
Në sytë e zhapikut e zuri gjumi

Dielli si një patate e përskuqur
Lëshonte ca rreze ultraviolete
Mbi lëkurën e zeshkur të ditës
E cila pamëshirshëm vuante nga dehidrimi

NË KËTË QYTET PREJ GURI

Kur më ngacmon nostalgjia
Dal në qytet
Në takim me shirat e vjeshtës
Dal kur vdesin
Dhe ringjallen pemët

Ky qytet i kalldrëmtë
Ndërtuar nga ëndrrat
Dhe baladat e etërve krenarë
Sa herë që përmallohem
I drejtoj sytë e gështenjtë
Kah kalaja e Lidhjes së gjakut

Këtu njerëzit janë të heshtur
Jetojnë prej një moti të shkujdesur
Deri te një mot i lig
Po u deshtë pa kurrfarë hezitimi
Mitet dhe baladat sa ora zgjohen
Për ta mbrojtur qytetin e gurtë
Kur na i vrasin kuajt e fëmijërisë

KISHIM FRIKË NGA ZGJIMI I PLUMBAVE

Beteja veç kishte përfunduar
Nëpër skuta të errëta të korridoreve
Valëviteshin
Si lekat e menstruacioneve
Flamujt e grisur të luftës

Askund nuk i pamë fituesit
Edhe ata që humbën luftën
U dukën së sëmundja e keqe
Mbase i kishte përpi mortja e zezë
Vetëm heshtja bridhte ledheve

Heshtnim edhe ne që mbetëm
Gjysmë të gjallë
Kishim frikë nga zgjimi i plumbave
Sterra e dendur e mëngjesit
Notonte mbi barin e përgjakur

Çfarë nuk është njeriu në gjendje
Të bëj nga frika
E përpinë edhe gjuhën e vet
Vetëm të mos i dëgjohej zëri
Në brendinë e korridorit të lagshhtë

TEJ PËRTEJ I SHPOI MURET

Nuk di a thua vallë mëkatove
Kur ja ktheve shpinën atdheut
Pas shpine
Tej maleve të thepisur
Mina hedhësi këndonte
Një këngë të lashtë mortore

Nëpër xhade me trasta të grisura
Iknin dezertorët
Iknin duke ia kthyer shpinën atdheut
Mes dy betejave
Mbetën kuajt e ngordhur
Pamjet që na trishtonin në shikim të parë
Dikur vonë na dukeshin
Si lojëra fëmijësh
Kur vraponim pas pëllumbave
Krahë thyer që uleshin
Nëpër telat elektrike

Një rafal plumbash prej breshëri
Tejpërtej
I shpoi lagështit e mureve
Në hendekun e shtatë
Nëntë herë gjëmoi mëngjesi i ngrirë
Dikur vonë ndryshoi frymëmarrjen

KUR VINTE MBRËMJA

Më pëlqente lindja e diellit
Perëndimi dukej i trishtuar
Fundosej diku në ndonjë hon
Me tërë mallkimin e ditës
Fundosej për të mos u duk kurrë më

Kështu që kishim kohë
Deri në mbrëmje
Të meditojmë për kohën e adoleshencës
Të meditojmë
Për ledhatimet e flokëve të vashave
Në shenjë të dashurisë platonike

Kur vinte mbrëmja
Çasti kur si uragan rritej frika
E dielli na tradhtonte
Ne strukeshim nën sqetullat e njëri-tjetrit
Strukeshim si molat pa e ditur shpjegimin

Prishtinë, 9 mars 2019

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002 Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e

karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
10. “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,

13. "Puthja e gozhduar", poezi, "Qendra e Kulturës", Klubi letrar, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2009.
14. "Kashelasha në vargje", poezi për fëmijë," Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. "Pema e bekuar", E përkthyer, Rumani, 2010.
16. "Bajraktarët e vatanit", poezi satirike, Klubi letrar, "Fahri Fazliu" Kastriot, 2010.
17. "Hijet e ndryshkura", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
- 18."Stuhi në Kutulishte", poezi, "Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
19. "Posa ikte nata", poezi, "Qendra e kulturës ", Kastriot, 2010.
20. "Loja e myshqeve", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
21. "Lumëbardhi dhe gjëma", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010
22. "Metafora e heshtjes", poezi, "Qendra e kulturës", Kastriot, 2010
23. "Hyji në Prekaz", poezi,"Qendra e Kulturës", Kastriot, 2010.
24. "Sinorët e hinores", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. "Don Kishoti dhe Rosinanti", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26."Zjarri i dashurisë", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. "Kur likenet vallëzojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. "Ditari në vargje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
30. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35. “Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41. ”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
- 79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
- 87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

91. "KraKëllimat e natës", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
92. "Ndjekësit e enigmave", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
93. "Atdheu i paçmuar" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
94. "Psalm i harruar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
95. "Për kë po bie moj kambanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
98. "Loti i gotës së dehur", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
99. "Stina asnjane", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
100. "Dëneste bashkë me erën" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
101. "Druri i pikëlluar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
102. "Një grusht dashuri", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
103. "Lëreni zërin tim", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
104. "Shi në qytetin tim", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
105. "Si trenat e verbër", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
106. "Zjarri i malli tim", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014

107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 110.”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
- 116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015

122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
- 123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
138. “Nuk i them unë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141. “Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
142. “Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143. “Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144. “Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145. “Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146. “Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147. “Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148. “Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149. “Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
150. “Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
151. “Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017

- 152.“Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2018
- 153.“Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 154.“i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2018
- 155.“Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 156.“Gurët e pjekur shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 158.“Ishin thyer te gjitha urat ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 159.“Gjethi i këputur në vjeshtë ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 160.“Ti mundesh nëse do” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 161.“Pëllumbat prej rrufeve”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
162. “Diku në zbrazëtinë e ndërgjegjes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 163.“Retë e dendura të kujtesës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 164.“ Pak diell e shumë acar”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 165.“Kur kyçen yjet e harresës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 166.“Nga pragjet e shtëpive”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019

167. “Fluturat e djegura ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
168. “Përtej asaj peme”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
169. “ Kuajt e mjegullave”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
170. “Po të ishte ndryshe ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
171. “Kur kthehen zogjtë e shiut ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
172. “Mes gishtave të hijes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
173. “kush i theu xhamat e shiut”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
174. “Poemat e dhembjekrenarisë ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
175. “Marsi i çmendur në dy kohës”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
176. “ Kur dënesin varret”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
177. “ Mos më uroni udhë të mbarë”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë
178. “Nuk mjafton të kesh vetëm emër ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
179. “Portat e mbyllura me dyllë ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020
180. “Deri në baladën tjetër ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

Cikli i parë

Atdheu im i mjerë toka ime e djerrë.....11

Kthehej si një bumerang i zjarrtë.....13

Bereqeti kishte vdekur nëpër fusha.....15

Shikoj me vëmendje dhe dëgjoj.....16

Pashë vdekjen time.....17

Pastaj zgërdheshej derisa nuk çmendej.....18

Por zhurma e vrazhdë e lopatës.....19

Për hajnit tona të vogla.....20

Kënaqesha si askush tjetër.....21

Sa qenkam me fat.....22

Por kurrë nuk do të pranoja.....23

Atdheu im i mjerë toka ime e djerrë.....24

Në hapësirën e përhitur.....25

Jemi ose nuk jemi njerëz.....26

Ishte koha e vdekjeve.....27

Por gjithsesi ishte një kohë asnjane.....28

Një stuhi e uritur pështillej.....29

Pashë se si iu nxinë kokrrat e syve.....30

Pastaj të marr udhën e kalasë.....31

E t'i numëroj meteorët.....32

Thuajse një dorë ua vuri zjarrin.....33

Ishte koha kur piqeshin ftonjtë.....34

Ky dimër e kjo dëborë.....35

Ata s'kishin asgjë përpos shpirtit.....36

Cikli i dytë

Po ashtu një shi i çmendur.....37

I kishte dehur kaprojtë e thinjur.....	39
Digjeshin gurtë e ngulur në dhe.....	40
Pemët lakuriqe në dy gjunjë.....	41
Në mes të udhës së thyer.....	42
Të grisura si hartat e atdheut.....	43
Dy flutura mbi tavolinë.....	44
Posa ia nisin fluturimit.....	45
Si zogjtë e egër pa pendla.....	46
Këmishët e grisura dhe njeriu lakuriq.....	47
Jo se jo.....	48
Dielli këtu lind në perëndim.....	49
Asnjë qen endacak.....	50
Nën ingranazhet e vdekjes.....	52
Si t'i shëroj plagët e luftës.....	53
Nuk di a thua vallë më duhet.....	54
Fshiheshin merimangat e zeza.....	55
Duhej të bartej dhembja.....	56
Po ashtu një shi i çmendur.....	58
Derdhej nga kazanët e shqyer.....	59
I pamë kufomat.....	60
Një plumb dredharak.....	61
I njohu qeshjet ironike.....	62
I cili ende nuk është nisur.....	63
Qenkan qarar peshë retë.....	64
Mund të them edhe shtatë.....	65
Desha të blej një gjysmë ëndrre.....	66
Na i shënojnë të gjitha ëndrrat.....	67
Sonte kjo natë e askujt.....	68
<i>Cikli i tretë</i>	
<i>Deri në baladën tjetër.....</i>	<i>69</i>

DERI NË BALADËN TJETËR

Ti mos harro koha është.....	71
Nuk di cili djall hyri.....	73
Dridheshe si thupra e çeliktë.....	74
Fluturat e bardha dhe të kaltra.....	75
Si drurët stepeshin njerëzit.....	76
Asaj i mungonin lekët për arkivol.....	77
Nga brendia e saj.....	78
Nuk u përkulem asnjëherë.....	80
Deri në baladën tjetër.....	81
U harruan të gjitha mallkimet.....	82
Kali im i pafat.....	83
Dielli si një patate e djegur.....	84
Në këtë qytet prej guri.....	85
Kishim frik nga zgjimi i plumbave.....	86
Tej përtej i shpoi muret.....	87
Kur vinte mbrëmja.....	88

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Deri në baladën tjetër / Adem Zaplluzha. - Prishtinë
: Trendi, 2020

. - 106 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-757-44-7